Nr. Tel: +35567 201 3321 , ose e-mail: info@certis.com.al.

KONTAKT:
info@certis.com.al www.certis.com.al +355672013321

Prova 3:

- **Licenca Nr. 16975/2**, datë 04.10.2023, Tiranë për: Operator në shërbimet funerale; Operator në transportin e të ndjerit; Menaxher teknik dhe operacional në shërbimet funerale; Menaxhim mjedisor dhe mbetjeve në aktivitetet e punës; Identifikimi dhe vlerësimi mjedisor dhe i ndikimeve në mjedis, "Menaxhimi i emergjencave mjedisore; Monitorimi dhe vlerësimi i mikroklimave në ambientet e punës (pluhurat, zhurmat, ndriçimi);

- Licenca Nr. 8716/2, datë 20.06.2023, Tiranë për: Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi, Përgjegjës kompanie për emergjencat, evakuim dhe mbrojtjen nga zjarri, Njohuri dhe përdorim i mjeteve të fikjes së zjarreve dhe Ndihma e parë dhe Higjiena në Punë dhe

- Licenca Nr. 3395/2, datë 16.03.2021, Tiranë për: Përgjegjës për shëndetin dhe sigurinë në punë. Plane emergjencash dhe evakuim nga zjarri dhe Auditor dhe kontrollator HACCP.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
ZËVENDËSMINISTRI

Nr. 16975/2 prot.

Tiranë, më 4.10.2023

Lënda: Miratim kërkese

QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT
Adresa: Bulevardi "Zhan D'ark", Prona Nr. 33, Tiranë

Në zbatim të pikave 5 dhe 6 të Nenit 20 të Ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009, "Për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë ", të pikës 5 Kreu II , të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.05.2009 "Për licensat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qëndrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregulla të tjera nënligjorë të përbashkëta ", i ndryshuar, të pikës 9 të Udhëzimit të Ministrit, nr. 1457, datë 28.07.2009 "Për procedurën e shqyrtimit të kërkesave për licensim, të subjekteve që kryejnë veprimtari të formimit profesional", i ndryshuar "Për licensat e grupit të tretë, Kategoria X.2.B, bazuar dhe në shkresën Nr.2998/1 Prot., datë 28.09.2023, të Agjensisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi,

Miratoj:

Kërkesën e subjektit "Re Born", për ndryshimin në Licencën për Formim profesional të listës të kurseve për formim profeslesional dhe ofrimin e kurseve: "Operator në shërbimet funerale", "Operator në transportin e të ndjerit", "Menaxher teknik dhe operacional në shërbimet funerale", "Menaxhimi mjedisor dhe i mbetjeve në aktivitetet e punës", "Identifikimi dhe vlerësimi mjedisor dhe i ndikimeve në mjedis", "Menaxhimi i emergjencave mjedisore", dhe "Monitorimi dhe vlerësimi i mikroklimave në ambientet e punës (pluhurat, zhurmat, ndricimi).

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

ZËVENDËSMINISTËR

Olta MANJANI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
ZËVENDËSMINISTRI

Nr. 8716/2 prot.

Tiranë, më 20.6.2023

Lënda: Miratim kërkese

QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT
Adresa: Bulevardi "Zhan D'ark", Prona Nr. 33, Tiranë

Në zbatim të pikave 5 dhe 6 të Nenit 20 të Ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009, "Për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë ", të pikës 5 Kreu II , të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.05.2009 "Për licensat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qëndrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregulla të tjera nënligjorë të përbashkëta ", i ndryshuar, të pikës 9 të Udhëzimit të Ministrit, nr. 1457, datë 28.07.2009 "Për procedurën e shqyrtimit të kërkesave për licensim, të subjekteve që kryejnë veprimtari të formimit profesional", i ndryshuar "Për licensat e grupit të tretë, Kategoria X.2.B, bazuar dhe në shkresën Nr.1564/1 Prot., datë 19.05.2023, të Agjensisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi,

Miratoj:

Kërkesën e subjektit "Re/Born", për ndryshimin në Licencë për Formim Profesional të listës së kurseve për formim profesional dhe ofrimin e kurseve: "Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi"; "Përgjegjës kompanie për emergjencat, evakuimin dhe mbrojtjen nga zjarri"; "Njohuri dhe përdorim i mjeteve të fikjes së zjarreve" dhe "Ndihma e parë dhe Higjena në Punë".

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

ZËVENDËSMINISTËR

Olta MANJANI

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3; Tiranë, Albania; www.financa.gov.al; info@financa.gov.al

QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT
Nr. 3790 Prot.
Data 18.3.2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
ZËVENDËSMINISTRI

Nr.3395/2 prot. Tiranë, më 16.03.2021

Lënda: Miratim kërkeses për licensim për ndryshim

QENDRËS KOMBËTARE TË BIZNESIT
Adresa: Bulevardi "Zhan D'ark", Prona Nr. 33, Tiranë

Në zbatim të pikave 5 dhe 6 të Nenit 20 të Ligjit nr. 10081, datë 23.02.2009, "Për licensat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë ", të pikës 5 Kreu II , të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.05.2009 "Për licensat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qëndrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe disa rregulla të tjera nënligjorë të përbashkëta ", i ndryshuar, të pikës 9 të Udhëzimit të Ministrit, nr. 1457, datë 28.07.2009 "Për procedurën e shqyrtimit të kërkesave për licensim, të subjekteve që kryejnë veprimtari të formimit profesional", i ndryshuar "Për licensat e grupit të tretë, Kategoria X.2.B, bazuar dhe në shkresën Nr.582/1 Prot., datë 01.03.2021, të Agjensisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi,

Miratoj:

Kërkesën e subjektit "Re-Born" për ndryshim në licensën për formimim profesional dhe ofrim të kurseve përkatësisht:

- Ndryshim të adresës së ushtrimi të aktivitetit në adresën e re " Njësia bashkiake nr.9, Rruga "Reshit Petrela", ZK nr.8330, nr pasurie 7/168+1-N7
- Shtim të listës ekzistuese të kurseve me kurset: "Përgjegjës për shëndetin dhe sigurinë në punë", "Plane emergjencash dhe evakuim nga zjarri dhe "Auditor dhe kontrollator HACCP".

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

ZËVENDËSMINISTËR
Dajna Sorensen

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË TIRANË

Të gjitha dëshmitë që u cekën dhe u sqaruan më lartë, konfirmojnë pretendimin tonë ankimor se certifikata e prezantuar nga konsorciumi i rekomanduar për kontratë është e pavlefshme dhe realisht janë ofruar dëshmi të rrejshme të cilat dëshmi duhet ta diskualifikojnë konsorciumin e rekomanduar për kontratë nga pjesëmarrja në prokurim publik deri në një periudhë një vjeçare sipas nenit 99.2 të LPP-së.

Në lidhje me këtë pretendim ankimor, autoriteti kontraktues ka kërkuar sqarime nga OE i rekomanduar për kontratë me dt.03.04.2025, ku në sqarime e ka cekur si më poshtë:

Bazuar ne vendimin e e ekspertit shqyrtues dhe vendimin e organit shqyrtues të prokurimit me numër 2024/1051 ju lutem te na ofroni dëshmitë dhe komunikimin me Operatorin ekonomik qe ka lëshuar certifikatën me numër 1175487979. Ju lutem te paraqitni te gjitha argumentet ne pajtim me nenin 72 te LPP-se se certifikata e dorëzuar eshte ne pajtim me kërkesat e A.K. Asnje sqarim ne kundërshtim me nenin 72 te LPP-se nga O.E nuk do te pranohet nga ana e A.K .

Grupi i OE të rekomanduar për kontratë ka ofruar sqarime me dt.08.04.2025, duke theksuar se kërkesa për akreditim nuk është parashikuar në dosje të tenderit.

Pikërisht nga ky fakt kuptohet që Re/Born nuk ka të drejtë të lëshojë certifikata të tilla, prandaj nuk duhet të merret parasysh një certifikatë e tillë sepse është lëshuar nga një kompani që nuk ka të drejtë të lëshojë certifikata të tilla.

Ky rast është pothuajse i njëjtë sikur një universitet të lëshon diploma por që ky universitet të mos jetë i licencuar/i akredituar.

Po ashtu në përgjigje në lidhje me EN 15567-2 2015 grupi i OE të rekomanduar për kontratë është përgjigjur si më poshtë:

3. Interpretimi i Gabuar i Standardeve të Certifikimit

Pretendimi se **Re/Born Sh.p.k. nuk është subjekt i licencuar për këtë certifikim nuk është i bazuar në kërkesat e tenderit**. Kjo kompani ka licencime dhe certifikime për standarde të ndryshme të menaxhimit të cilësisë, përfshirë ISO dhe standarde të tjera relevante.

Për më tepër, standardi **EN 15567-2:2015 zakonisht lëshohet pas përfundimit të punimeve,** dhe jo si certifikim për trajnim paraprak. Prandaj, kërkesa për një certifikatë të tillë për trajnim është e pakuptimtë dhe në kundërshtim me praktikën e zakonshme të aplikimit të këtij standardi.

Këtë qëndrim e ka mbështetur edhe **instituti turk EUROGAP,** me të cilin kemi pasur komunikim, dhe të cilët kanë theksuar që ky standard aplikohet si certifikim përfundimtar dhe nuk është i përshtatshëm për lëshim në fazat paraprake të projekteve.

Nga kjo përgjigje kuptohet që edhe vetë OE i rekomanduar për kontratë e ka pranuar se Re/Born nuk është i certifikuar me standardin e kërkuar, pasi që edhe vetë grupi i OE të rekomanduar e kanë quajtur interpretim i gabuar i standardeve të certifikimit dhe e ka potencuar se ka certifikime të ndryshme të menaxhimit të cilësisë. Edhe ne nuk e kontestojmë që ka certifikime të ndryshme mirëpo në këtë rast është kërkuar standardi i

lartcekur e për të cilin standard nuk është i certifikuar Re/Born SHPK, prandaj nuk është plotësuar kërkesa e dosjes së tenderit.

Nëse ndonjë OE ka pasur ankesë apo paqartësi në lidhje me standardin e kërkuar atëherë ka qenë afati për sqarime dhe për kërkesë për rishqyrtim, mirëpo nuk ka pasur ndonjë ankesë në lidhje me këtë standard, prandaj kjo kërkesë duhet të përmbushet nga OE për tu shpallur të përgjegjshëm.

Me sqarime, grupi i OE të rekomanduar për kontratë ka ofruar edhe një sqarim nga Re/Born për certifikatat për trajnime, ku sqarimi mban datën 08.04.2025, e që ky dokument nuk duhet të merret parasysh se mban datën pas ofertimit dhe kjo bie në kundërshtim me nenin 72.3 të LPP-së.

Përveç këtij fakti, edhe në sqarim nuk jepet asnjë argument i detajuar për certifikatën e Endrit Sadiku, por ky sqarim është i përgjithshëm, ku shkruan:

RE|BORN

Tiranë, më 08.04.2025

Objekti: Objekti: Sqarim me kërkesë të të interesuarit për certifikatën e pjesmarrjes në trajnim të z. Endri Sadiku me dt lëshimi 23 gusht 2024.

Kompania Reborn shpk prej vitit 2019 është licensuar sipas Legjislacionit të Republikës në Shqipëri për formin profesional mbi standarded ISO.
Bazuar mbi këtë, eksperiencën e lektorëve tanë, bashkëpunimeve brënda dhe jashtë shtetit ne kemi arritur të bëjmë kurse të ndryshme mbi standarded ISO të cdo lloj qëllimi.

Edhe në këtë rast kemi realizuar një formim profesional teoriko praktik me lektorë shqiptarë mbi njohuritë e standardid referues në fjalë por edhe bashkëpunimit me një alpinist të shquar shqiptar, z. ENIS SHEHU. Pra kemi dhënë të gjitha njohuritë tona mbi pjesëmarrësit e kursit.

Ne këmi të drejtë që për kurset e licensuara shkruajmë "Certifikatë Kualifikimi" dhe për ato të pa licensiara "Certifikatë Pjesëmarrje".
Prandaj e këmi bërë ashtu se mesa mbaj mend ashtu kërkohej edhe në kërkesat e tenderit.
Pra thjesht si një certifikatë njohurish.

Për këtë arsye certifikatat tona janë të rregullta dhe skemi shkelur asnjë ligj të Republikës së Shqipërisë.

Me respekt,

Shoqëria "Re/Born" shpk
Përfaqësuar rregullisht nga
Emilian BIÇAKU

Emilian Biçaku

Administrator

Re/Born sh.p.k
L71309039P
TIRANE - ALBANIA

Në këtë sqarim nuk shkruan se për çka është licencuar Endrit Sadiku dhe nuk jepet asnjë detaj tjetër, e po ashtu nuk shkruan se për çfarë kurse kanë të drejtë të mbajnë trajnime kjo kompani, e as nuk shkruan se a është e akredituar për këto trajnime, prandaj ky sqarim nuk ka asnjë vlerë pozitive në raport me arsyetimin e AK-së, përveç se e konfirmon pretendimin tonë ankimor se kompania në fjalë nuk ka të drejtë të mbajë trajnime për EN 15567-2 2015, për trajnim të instruktoreve që do të monitorojnë parkun e aventurave.

Po ashtu tek objekti në këtë sqarim shkruan se sqarimi është për certifikatën e pjesëmarrjes së Endrit Sadiku, ndërsa në brendi të tekstit sqarohet se për kurset e pa licencuara kanë të drejtë të lëshojnë certifikata pjesëmarrje.

Pra edhe nga vetë sqarimi shihen kundërthëniet dhe fakti që kjo kompani nuk ka të drejtë të lëshojë certifikata, e po ashtu nuk ka mundur ta argumentojë në asnjë mënyrë një gjë të tillë.

OSHP-ja ka lëshuar vendime dhe ekspertiza ku nuk janë marr parasysh lëshimet e certifikatave nga kompani që nuk janë të akredituara, ju lutem referoju super ekspertizës të dt.05.12.2025 me Nr. 2023/0775 dhe vendimit Nr. 2023/0775 të dt.18.12.2023. Poashtu vendimi Nr.2024/1205 i dt.04.02.2025.

Me sqarime OE i rekomanduar për kontratë e ka cekur se ka një marrëveshje me kompaninë Turke EuroGap, mirëpo me qasjen e kufizuar që na është ofruar neve, asnjë dëshmi në lidhje me këtë kompani nuk ka qenë e bashkangjitur me ofertë, prandaj kjo dëshmi përbën ndryshim material dhe nuk mund të merret parasysh. Këto dëshmi mbajnë datën 27.09.2024, mirëpo këto dokumente nuk janë të noterizuara dhe realisht nuk mund të vërtetohen objektivisht se kanë ekzistuar para datës së hapjes së ofertave sipas nenit 72.3 të LPP-së, prandaj nuk mund të merren parasysh këto dëshmi sepse përbëjnë ndryshime materiale.

Pavarësisht këtij fakti edhe nëse ky dokument ka qenë i bashkangjitur me rastin e ofertimit përsëri nuk ka ndonjë rëndësi sepse nuk përmbushet kërkesa e dosjes së tenderit, sepse Euro Gap në dokumentin e ofruar shkruan se me kërkesë të kompanisë OKKO mund të kryej aktivitete inspektimit etj. Pra Eurogap mund ti kryej shërbime kompanisë OKKO por askund nuk shkruan se kjo kompani mund ti kryej kompanisë DAQA.

Daqa ka ofruar një marrëveshje me kompaninë OKKO Global, mirëpo nga këto dëshmi kuptohet qartë se OKKO GLOBAL nuk është e certifikuar për certifikime, prandaj kjo marrëveshje nuk ka asnjë vlere në këtë rast dhe është në kundërshtim të plotë me dosje të tenderit, sepse dëshmia ka qenë si më poshtë:

Dëshmi. 5, OE duhet të ofrojë certifikaten, kontratën ose parakontratën, apo mareveshje me subjektin e certifikuar me EN 15567-2 2015 për trajnim të instruktoreve për këtë projekt.

Pra është kërkuar marrëveshje me subjektin e certifikuar, ndërsa OKKO GLOBAL nuk është subjekt i certifikuar, prandaj nuk është plotësuar kërkesa e FDT-së. Edhe nëse EuroGap është i licencuar kjo nuk ka ndonjë vlerë në këtë rast sepse DAQA nuk ka marrëveshje me EuroGap, por e njëjta ka marrëveshje me OKKO Global e që kjo kompani nuk është e certifikuar.

Duke pasur parasysh këtë elaborim, është definitivisht e qartë që OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm, pasi që nuk ka plotësuar kërkesën Nr.5 të nenit 9.1&9.2 të FDT-së.

Përveç këtyre fakteve, sqarojmë se edhe certifikimi ISO që e ka ofruar OE i rekomanduar për kontratë dallon me standardin EN të kërkuar në dosje të tenderit.

Shih më poshtë dallimin:

Dallimet ndërmjet standardeve ISO dhe standardit EN 15567

EN 15567 – Standard Evropian për kurset me litarë

Standardi **EN 15567** është një **standard teknik evropian**, i ndarë në dy pjesë kryesore:

- **EN 15567-1**: Kërkesat për ndërtimin dhe sigurinë strukturore të kurseve me litarë

- **EN 15567-2**: Kërkesat për operimin dhe menaxhimin e aktiviteteve në kurset me litarë

Ky standard është **i vetmi** që trajton në mënyrë specifike sigurinë dhe menaxhimin e strukturave të kurseve me litarë (rope courses), të cilat janë pjesë e zhvillimit të turizmit aventurë.

EN 15567 është **miratuar nga Komiteti Evropian për Standardizim (CEN)** dhe është i **detyrueshëm për të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe EFTA**, në rastet kur aplikohen struktura të tilla për përdorim publik apo komercial.

Në Kosovë, standardi **EN 15567** është **adoptuar si standard kombëtar** nga **Agjencia Kosovare për Standardizim (AKS)** dhe është i njohur si **SK EN 15567**, i cili përbëhet nga dy pjesë:

1. **SK EN 15567-1 :2015/A1:2023** – Kërkesat për ndërtimin dhe sigurinë strukturore të kurseve me litarë.
2. **SK EN 15567-2:2024** – Kërkesat për operimin dhe menaxhimin e aktiviteteve në kurset me litarë.

ISO – Standardet Ndërkombëtare

Organizata **ISO (International Organization for Standardization)** harton standarde ndërkombëtare të përgjithshme si: **ISO 9001; ISO 45001; ISO 14001, etj.**

Këto standarde janë të **përdorshme në sektorë të ndryshëm** por **jo për sektorin e kurseve me litarë**.

Përfundim

Standardi **EN 15567** përbën referencën kryesore dhe **bazën ligjore dhe teknike** për ndërtimin dhe funksionimin e kurseve me litarë në përputhje me kërkesat evropiane për siguri dhe menaxhim e cila është në fuqi edhe në Kososë përmes udhëzimit.

Aktualisht, **nuk ekziston një standard ekuivalent në ISO** që të mbulojë në mënyrë të drejtpërdrejtë kurset me litarë (rope courses).

Prandaj, për çdo projekt që lidhet me instalimin, mirëmbajtjen apo menaxhimin e kurseve me litarë, EN 15567 është standardi i domosdoshëm për t'u ndjekur e jo ISO standardet siç është rasti i kompanisë qe e ka lëshuar Certifikatën.

- **Grupi i OE të rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm sepse oferta e tyre ka pas shkëputje te vlefshmërisë së ofertave dhe shkëputje të sigurimit të ofertës.**

Autoriteti kontraktues nuk na ka ofruar qasje të plotë tek vlefshmëria e ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, prandaj ne konsiderojmë se oferta e OE të rekomanduar për kontratë ka shkëputje të vlefshmërisë së ofertës prej dt.30.11.2024 deri me dt.29.04.2025, ku kem dëshmi që e ka vazhdar validitetin e ofertës. Ndërsa Sigurimi i ofertës ka pas

shkëputje nga dt.29.12.2024 deri me dt.14.02.2025 (46 ditë), e që e bënë ofertën e OE të rekomanduar për kontratë të papërgjegjshme.

AK -së me dt.13.02.2025 ka kërkuar vazhdimin e sigurimin e tenderit dhe vlefshmërinë e tenderit, mirëpo OE i rekomanduar për kontratë e ka vazhduar vetëm sigurimin e tenderit, prandaj ky OE është i papërgjegjshëm sepse nuk ka vazhduar validitetin e ofertës, kurse oferta nuk mundet në asnjë mënyrë të mbetet pa validitet por duhet të ketë vazhdimësi të vlefshmërisë së tenderit pa shkëputje.

Edhe në kërkesë shkruan se nëse nuk vazhdohet validiteti dhe sigurimi OE shpallen të papërgjegjshme. Shih më poshtë:

Operatorër ekonomik të cilët nuk dorëzojnë Deklaratën mbi validitetin dhe nuk e vazhdojnë sigurimin e tenderit sipas kërkesës, ofertat e tyre do të shpallen si të papërgjegjëshme .

Këto kërkesa duhet të dorëzohen tek Autoriteti Kontraktues përmes Sistemit të E-Prokurimit deri më datë 14.02.2025 ora 16:00.

Edhe RRPP Nr.001/2022 e përcakton një gjë të tillë, shih më poshtë nenin 30.6.

30.6 Është e hapur për secilin OE të vendos nëse dëshiron të zgjatë validitetin e tenderit. OE të cilët vendosin të mos zgjasin validitetin e tenderëve të tyre do të refuzohet si "të papërgjegjshëm" dhe kështu AK nuk do të konfiskoj Sigurimin e Tenderit të tyre.

Pra, AK-së nuk na ka ofruar dëshmi se OE i rekomanduar për kontratë ka vazhduar vlefshmërinë e ofertës nga dt.14.02.2025, ndërsa grupi i OE të rekomanduar për kontratë ka vazhduar validitetin e ofertës nga data 29.04.2025-27.06.2025.

Ne me dt.16.05.2025 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim nga ana e AK-së, ku e njëjta e ka cilësuar kërkesën tonë si të pa bazuar, mirëpo që arsyetimin e saj nuk e ka mbështetur në fakte dhe dispozita konkrete ligjore.
Autoriteti kontraktues e ka cekur se nuk janë organ hetues për të hetuar dokumente dhe se certifikata i përmban elementet e kërkuara të dosje së tenderit, mirëpo kur ka pretendime të tilla duhet të kërkohen sqarime dhe të verifikohen këto pretendime, madje edhe OSHP-ja e ka cekur që duhet të bëhen verifikime.

Më tutje AK-së është përgjigjur si më poshtë:
Gjithashtu gjate fazes se vleresimit ne kemi kerkuar sqarime shtese nga ne pajtim me vendim e OSHP-se me numer 2024/1051 . Pas pranimit te sqarimeve ne pajtohemi me sqarimet e ofruara. Marreveshje me kompanine turke ka ekzistuar para hapjes se ofertave dhe eshte dokumente qe mund te vertetohet ne menyre objective. Me rastin e ofertimit marreveshja me kompanine turke ka qene pjese e dosjes se tenderit konkretisht dokumenti me numer rendor 20 tek formulary I tenderit I gjenruara nga sistemi dhe me numer 18 tek dokumentet e dorezuara me emer te Fajlit

18.DAQA- OKKO GLOBAL Marrveshje dhe Katalogu per instalimin e puneve sipas standartit EUROPEAN NORMS

Grupi Operatoreve ekonomik N.P.T. DAQA ; EING COM SH.P.K.,Magjistralja PR-SK/38, 70000, FERIZAJ, Kosovë ka 2 certifikata ne pajtim me kerkesat e Dosjes s etenderit dhe Njoftimit per kontrate. Ne kete pike ankesa juaj eshte e pabazuar .

Sa i përket sqarimeve dhe dëshmive të ofruara me sqarime, më lartë e kemi elaboruar në detaje se këto dëshmi nuk janë konform kërkesës së dosjes së tenderit, prandaj përgjigja e AK-së është e pa bazuar dhe e paqëndrueshme.

Autoriteti kontraktues nuk ka dhënë asnjë përgjigje në lidhje me pretendimin ankimor përkitazi me mungesën dhe shkëputjen e validitetit dhe sigurimit të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, prandaj kjo është dëshmi konkrete se nuk mund të arsyetohet veprimi i kundërligjshëm i AK-së dhe papërgjegjshmëria OE të rekomanduar për kontratë.

Duke u bazuar në dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë rezulton se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse është favorizuar operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë duke u rekomanduar për kontratë edhe pse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, ndërsa neve jemi diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse", mirëpo në këtë rast AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore sepse oferta e OE të rekomanduar për kontratë nuk i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit.

Duke u bazuar në të gjitha sqarimet e lartcekura dhe në dëshmitë e kërkuara, rezulton se në këtë mënyrë nuk mund të arrihet qëllimi i LPP-së, siç parashihet në nenin 1 të këtij ligji, e ku shkruan qartë: Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP-ja që të merr:

VENDIM

I. **APROVOHET,** si e bazuar ankesa e **Grupi të OE Dua arch SH.P.K & Dashnim Jashari B.I & TRIANGLE SH.P.K.**

II. **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM, ndërsa rivlerësimi i** ofertave të bëhet sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë përndryshe ne do të detyrohemi të vazhdojmë me ankesa dhe kundërshtime për këto shkelje në instancat tjera më të larta.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale do të analizohen me vonë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*